



Data/Date:	14.03.2025
Për/Za/To:	Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit
CC	Antigona Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit Komunal të Prizrenit
Tema/Subjekat/Subject	Raporti (me komente) për ecurinë e konsultimit për raportin për: Projekt-Strategjinë për sigurinë në institucionet edukative arsimore në Komunën e Prizrenit

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna me theks neni 30-Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

-Me **06.12.2024**, kryetari i Komunës, Shaqir Totaj ka formuar grupin punues për Hartimi e Projekt-Strategjinë për sigurinë në institucionet edukative arsimore në Komunën e Prizrenit. Anëtarët e këtij grupi janë: Reshit Kushaj, Atila Arzualxhiu, Adelina Hoxhaj, Fisnik Minci, Eroll Shabani, Haziz Krasniqi dhe Eleonora Fetollari-Bush.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **27.02.2025** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/02/Njoftim-per-organizimin-e-KONSULTIMIT-publik-per-Projekt-Strategjine-per-sigurine-ne-institucionet-edukative-arsimore-ne-Komunen-e-Prizrenit-shq-bosh-tur-rom.pdf>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42777>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-projekt-strategjine-per-sigurine-ne-institucionet-edukative-arsimore-ne-komunen-e-prizrenit/>

Me 28.02.2025 është publikuar njoftimin në rrjetin social facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1A149RpMVc/>

Me 28.02.2025, njoftimi dhe projekt-strategjia (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

Me 10.03.2025, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

Në facebook:

Me 11.03.2025, është publikuar procesverbali për mbajtjen e konsultimit publik, procesverbali është i publikuar në këtë vegëz:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/03/Procesverbali-per-Projekt-Strategjine-per-sigurine-ne-institucionet-edukative-arsimore-ne-Komunen-e-Prizrenit-PDF-SCAN.pdf>

Dokumenti ka qenë në konsultim publik në uebfaqen zyrtare të komunës dhe platformën e konsultime publike, nga data **27.02.2025** deri me **14.03.2025**, ndërsa komentet janë pranuar deri me datë **14.03.2025**.

Tabelori me të dhëna të shkurtra:

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	Numri i kërkesave të pranuar
1-Takime i drejtpërdrejtë me qytetarë për Raporti për: Projekt-Strategjinë për sigurinë në institucionet edukative arsimore në Komunën e Prizrenit	10.03.2025 Nga-11:05 Deri-12:02	F M T 17 23 40	7	20 0-Pjesërisht 14-Refuzohen 6-Pranuara 0-Adresuar

Nr	Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë/ sugjerim	Statusi i kërkesës: Pranuar: Pjesërisht: Refuzuar: Adresuar	Komisioni ka mbajtur takim me: 14.03.2025 për shqyrtimin e komenteve/kërkesave të pranuar nga qytetarët
1	1.Dokumentit-strategjisë ti shtohet edhe Infrastruktura shkollore për fëmijët me aftësi të kufizuara, nëpër hapësira jashtë shkollës, brenda saj, në klasa, në tualete etj.	Vlora Karavidaj	Pranuar	Përfshirja e infrastrukturës për fëmijët me aftësi të kufizuara, si në hapësirat jashtë shkollës, brenda saj, në klasa, dhe në tualete, është një hap i rëndësishëm për të siguruar mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit dhe për të ndihmuar në integrimin e tyre të plotë në procesin edukativ. Kjo është një praktikë e nevojshme që promovon ndjenjën e sigurisë dhe përfshirjes për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe është një hap përpara në drejtim të krijimit të një sistemi arsimor të barabartë dhe të gjithanshëm. Shumë shpejtë do të planifikohet edhe buxheti për këtë infrastrukturë. Përndryshe ekzistojnë kriteret dhe standardet ligjore që përcaktojnë qartë ndërhyrjet infrastrukturore të objekteve publike sidomos të atyre shkollore.

2	1.Pregatitja e një personi që ka me mbikëqyrë sigurinë nëpër shkolla.	Bashkim Rakaj	Pranuar	Në dokumentin e strategjisë është planifikuar që në secilën shkollë të krijohen burime njerëzore që merren me çështjet e sigurisë në shkolla. Propozim i pranuar, personi që do të angazhohet duhet të njohë politikat dhe procedurat e sigurisë që janë të zbatueshme në shkollë, përfshirë: Rregullat e mbrojtjes së nxënësve dhe stafit; Procedurat e evakuimit në rast emergjence;
	2.Një person të merret vetëm me menaxhimin e çështjeve problematike.		Pranuar	Në dokumentin e strategjisë është planifikuar që në secilën shkollë të krijohen burime njerëzore që merren me çështjet e sigurisë në shkolla, përfshirë çështjet menaxheriale të sigurisë. Personi i angazhuar duhet të trajnohet për politikat e mbrojtjes ndaj abuzimit, dhunës dhe ngacimit, normat dhe standardet për sigurinë e infrastrukturës shkollore.
	3.Ushqimi të jepet nëpër shkolla, të krijohen ambiente që fëmijët të mos kenë nevojë me dal jashtë objektit shkollor.		Refuzuar	Sigurimi i ushqimit në shkolla nuk ndikon drejtpërdrejtë në çështjet që lidhen me sigurinë.
	4.Trajtimi i shëndetit mendor të fëmijëve me sjellje devijonte, mbikëqyrja përmes punëtorit social dhe psikologëve nëpër shkolla.		Refuzuar	Kjo fushë është e përfshirë në dokumentin e strategjisë.
2	1.Vendosja e pengesave në rrugë në afërsi të objektit shkollor “Luciano Motroni”.	Mehdi Krasniqi	Refuzuar	Infrastruktura e përshtatshme në afërsi të objekteve shkollore është e përfshirë në dokumentin e strategjisë.
	2.Nxënësit që vijnë nga fshatrat si Zhupa të iu sigurohet transport deri në shkollë(sepse autobusi që i sjell në qytet i le larg nga shkolla).		Refuzuar	Çështja e transportit është e rregulluar me udhëzimet administrative gjegjëse.
3	1.Duhet te jemi transparent dhe të shohim kush janë anëtarët e komisionit që e kanë hartuar këtë strategji.	Tringa Kasemi	Pranuar	Anëtarët e grupit punues janë: Reshit Kushaj, Atila Arzuaxhiu, Adelina Hoxhaj, Fisnik Minci, Eroll Shabani, Haziz Krasniqi dhe Eleonora Fetollari-Bush.
	2.Duhet ta dimë sa kemi buxhet për ti realizuar gjitha këto pika të planit të strategjisë për sigurinë.		Refuzuar	Aktivitetet që kanë kosto mbulohen nga përbrenda komunitetit shkollor në kuadër të veprimtarisë së përditshme shkollore, gjersa DKA siguron mjetet nga buxheti vetanak.

	3. Te merren masa pasi që në ambientet shkollore ka raste kur pihet cigarja, monitorimi nga mësimdhënësit dhe inspektoriati në afërsi të dyqanet që shesin.		Refuzuar	Çështjet disiplinore brenda dhe jashtë objekteve shkollore janë të rregulluara me Rregulloren Komunale për institucionet edukative arsimore.
4	1. Të investohet në shkallë emergjente nëpër shkolla.	Shqipe Shatri	Refuzuar	Janë standardet teknike dhe kriteret për ndërtimin e objekteve edukative arsimore, ku përcaktohet se shkallët emergjente duhen ndërtuar / vendosur në objektet tri katëshe e më lartë.
	2. Të shtohet numri i psikologëve shkollore nëpër fshatra.		Refuzuar	Ekziston Udhëzimi Administrativ dhe politikat e MASHTI-t që rregullojnë angazhimin e psikologëve shkollore.
	3. Ndalimi i postimeve dhe komenteve nga ana e mësimdhënësve nëpër rrjete sociale me qëllim fyere e sharje ndaj punës së njëri tjetrit.		Refuzuar	Duhet zhvilluar një politikë shtesë në kuadër të rregullores për disiplinë dhe kodit etik. Ekziston Kodi Etik i punonjësve të komunës që përfshin çështjen e ngritur.
5	1. Me qenë prezent edhe drejtorja e inspektoriatit dhe shërbimeve publike kur mbahen dëgjime të tilla.	Nexhdet Mrasori	Refuzuar	Në dëgjime janë ftuar të gjithë hisedarët, është në përgjegjësi të palëve të cilat nuk kanë marrë pjesë për të dhënë kontributin e tyre.
	2. Bashkëpunim kemi gjithmonë në patrullim nëpër shkolla. (Ka ligjërata nëpër shkolla në koordinim me DKA për bullizmin, lëndët narkotike etj).		Refuzuar	Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës është duke vazhduar. Pjesë e planit vjetor të punës së policisë është mbajtja e ligjëratave nëpër shkolla.
	3. Sigurimi nëpër shkolla të kryhet (paguhet) nga komuna dhe të mos jetë nga prindërit.		Refuzuar	Kjo është një politikë ndaras që duhet zhvilluar nga institucionet tjera komunale dhe nuk bën pjesë në dokumentin e strategjisë.
	4. Rrethojat nëpër shkolla të vendosen sa më parë aty ku ka nevojë.		Refuzuar	Rrethojat nëpër shkolla nuk përcaktojnë ngritjen apo uljen e nivelit të sigurisë. Praktikant kanë treguar se jo çdo herë rrethojat kanë ndikuar në rritjen e sigurisë.
6	1. Këshilli për siguri të bëhet edhe me përfaqësues të fshatrave dhe drejtorë të gjitha shkollave dhe të mbahet evidenca kur dikush mungon në takimet e keshillit.	Simon Veseli	Pranuar	Duhet përfshirë komuniteti prindëror në grupet shkollore që merren me çështjet e sigurisë në shkolla.
7	1. Kush i mbikëqyr se sa po punohet për implementimin e këtij plani për strategjinë.	Linda Simitqiu	Pranuar	Do të bëhen raporte të rregullta nga drejtorët e shkollave dhe DKA në bazë gjysmë-vjetore. Anëtarët e kuvendit komunale kanë të drejtë të kërkojnë raporte periodike.

Në këtë vegëz:

https://www.facebook.com/watch/live/?ref=watch_permalink&v=620241530623918&rdid=mL6IGiAoKDIuBK15 , mund të gjeni video incizimin e konsultimit publik.

Shkurtesat:

F-Femra

M-Meshkuj

T-Totali

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik,
2. Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e strategjisë,
3. Lista e takimit të anëtarëve të grupit punues,
4. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik.

Raporti është përgatitur nga :

Grupi për hartimin e strategjisë